



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

02-10-2023

Titull - Përkrahje Mëdha			
Nr. i organit	Numri i Broj	Titulli	
Org. broj			

01-119/05-1196



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.1 dhe paragrafi 12.2 shkronja d, neni 40.2 shkronja c të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), bazuar në nenin 4 të Ligjit Nr. 08/L-235 – për ndryshim dhe plotsimin e ligjit nr 08/L-193 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 08/L-213. Nenin 2 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-49, i ndryshuar dhe plotësuar nga Ligji Nr.05/L-108 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, neni 36, paragrafi 36.2, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më datën 27.09.2023, merr këtë:

V E N D I M

për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të vitit 2021 në vitin 2023

Neni 1

Me këtë, Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për bartjen e Buxhetit Komunal nga të hyrat vetanake të pashpenzuara të vitit 2021 në vitin 2023. Bilancet e pashpenzuara të të hyrave vetanake të komunave për bartjen në Buxhetin Komunal në vlerë prej **39,481.10 €** të vitit 2021 në vitin 2023.

Neni 2

Bartja e Buxhetit komunal nga të hyrat vetanake komunale propozohen të shpërndahen në këto kategori ekonomike:

- | | |
|------------------------------------------|--------------|
| 1. Mallra e shërbime në shumë prej | 5,880.76 €; |
| 2. Subvencione e transfere në shumë prej | 23,410.00 €; |
| 3. Investime kapitale në shumë prej | 10,190.34 €. |

Të shpërndara në këto nënprograme buxhetore:

Në kategorinë ekonomike mallëra dhe shërbime, shuma prej 5,880.76 € në nënprogramet:

- Infrastruktura publike (18193), shuma prej 4,043.74 €;
- Shërbimet e shëndetësisë primare (74950), shuma prej 1,511.81 €;
- Administrata (92165), shuma prej325.21 €.

Në kategorinë ekonomike Subvencione dhe transfere, shuma prej 23,410.00 € në nënprogramin:

- Zyra e Kryetarit (16033), shuma prej 23,410 €.

Në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale, shuma prej 10,190.34 € në nën programin:

Buxhetimi (17533), shuma prej 7,984.30 € në projektin:

- Participim i projekteve me donatorë, kodi (90552), shuma prej 7,984.30 €.

Shërbimet e shëndetësisë primare (74950), shuma prej 2,022.46 € në projektin:

- Renovimi i ambulantës në Viti, kodi (53893), në shumë prej 2,022,46 €.

Arsimi i mesëm (95160), shuma prej 183.58 € në projektin:

- Riparime i shkollave në Viti, Radivojc, Devajë, Pozheran, Ramjan, Gërmovë, Zhiti, Goshicë, Verban dhe Ramnishtë, kodë (53880), shuma prej 183.58 €.

Arsyetim:

Në kërkesën për bartje të mjeteve të pashpenzuara nga të hyrat vetanake të vitit 2021 në vitin 2023 nuk ka ndryshim në strukturën e shpenzimeve.

Bartja e të hyrave në vlerë 5,880.76 €, në mallra dhe shërbime bëhet për arsye të pagesës së obligimeve ndaj operatorve ekonomik në sektorin e shërbimeve publike, bartja e të hyrave në kategorinë e shpenzimeve subvencione dhe transfere në vlerë 23,410 € bëhet për pagesën e obligimeve të shpenzimeve të varrimi, ndërsa bartja e të hyrave në kategorinë e shpenzimeve kapitale në vlerë prej 10,190.34 €, në projektet: participim I projekteve me donatorë (mbulohet nga mbetja e mjeteve të projekteve të përfunduara), Renovimi i ambulants në Viti dhe mbetja e mjeteve në projektin, Riparimi i shkollave në Viti, Radivojc, Devajë, Pozheran, Ramjan, Gërmovë, Zhiti, Goshicë, Verban dhe Ramnishtë bëhet për mbulimin e planit të shpenzimeve të këtyre projekteve kapitale.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset kryetari dhe Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim e Komunës së Vitisë.

Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 8 lidhur me nenin 9 të Rregullores Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi ju dorëzohet:

1. Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim;
2. Zyrës së Kryetarit;
3. Shërbimit të Kuvendit; dhe
4. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
KRYESUESI
Bekim Azizi

